



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 1631/15 Prot.

Pogradec, më 18.05. 2025

Lënda : Dërgohet material për shqyrtim e miratim paraprak.

Znj. MANJOLA KAMOLLI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar Znj. Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues,

“PËR MIRATIM TË IMPLEMENTIMIT NË RAST APROVIMI TË PROJEKTIT STRATEGJIK ME TITULL “CIRCLE” NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË PARA ANTARËSIMIT, IPA III, PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR GREQI-SHQIPËRI 2021-2027”

Me respekt,

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



Nr.i faqeve A4 të projekt-vendimit : 2

Nr.i faqeve A4 të relacionit shoqërues : 4

Nr. i fletëve të dokumentave që shoqërojnë projekt-vendimin :9



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ . 2025

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____, Datë ____ . ____ . 2025

PËR

“ MIRATIMIN E IMPLEMENTIMIT NË RAST APROVIMI TË PROJEKTIT STRATEGJIK ME TITULL “CIRCLE” NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË PARA ANTARËSIMIT, IPA III, PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR GREQI-SHQIPËRI 2021-2027”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 28, pika 1, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 32, të Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr.450 datë 26.07.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritimit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore” pika 1 dhe 2 gërma (b) dhe (d) Koordinimi i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe projekteve ku përfiton Bashkia, në lidhje me aplikimin në projektin strategjik me titull “CIRCLE”, në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi-Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantarësimit (IPA III) 2021-2027, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë implementimin në rast aprovimi të projektit strategjik me titull “CIRCLE”, në kuadër të instrumentit të para antarësimit, IPA III, financuar nga Programi i bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi -Republika e Shqipërisë, 2021-2027.



2. Bashkia Pogradec, si partner në këtë projekt, bazuar në kushtet dhe kriteret e aplikimit në projekte IPA, në rastin e miratimit të projektit nga vlerësuesit e Delegacionit Evropian, të marrë përsipër mbulimin e kostos së bashkëfinancimit të projektit dhe TVSH-së bazuar në buxhetin e palës shqiptare dhe përfshirjen e kësaj kostoje dhe TVSH-së në buxhet.
3. Për zbatim të këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, Njësia e Integritimit Evropian dhe administrata e Bashkisë Pogradec të ndjekë të gjitha hapat e duhura për ecurinë e projektit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

K R Y E T A R

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
NJËSIA E INTEGRIMIT EVROPIAN

Nr. 1639 Prot.

Pogradec, më 18.09. 2025

RELACION

E nderuar Znj. Kryetare,
Të nderuar këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 28, pika 1, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, “, nenit 32, të Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr.450 datë 26.07.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integrimit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njërive të vetëqeverisjes vendore” pika 1 dhe 2 gërma (b) dhe (d) Koordinimi i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe projekteve ku përfiton Bashkia, në lidhje me aplikimin në projektin strategjik me titull “CIRCLE”, në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi–Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantarësimit (IPA III) 2021-2027,

- Mbështetja dhe drejtimi i strukturave administrative të Bashkisë për përgatitjen e projekteve në kuadër të programeve të asistencës së Bashkimit Evropian si dhe informimi i qartë për Thirrjet për Aplikime të shpallura në kuadër të Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Territorial të Bashkimit Evropian.
- Bashkërendimi dhe koordinimi me strukturat e Bashkisë dhe Këshillin Bashkiak për përfshirjen e të gjitha projekteve të financuara nga donator në buxhetin vjetor si dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm si dhe parashikimin e detyrueshëm të kostos lokale, bashkëfinancimit nëse ka dhe TVSH,

Ju paraqesim për miratim paraprak në rast fitimi të projektit strategjik me titull “CIRCLE”

Ky projekt është në kuadër të granteve të thirrjes së parë për propozime të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar 2021-2027 Greqi -Republika e Shqipërisë,



Partner në këtë projekt janë:

1. WASTE MANAGEMENT OF WESTERN MACEDONIA SA lider projekti. Greqi
2. HELLENIC RECYCLING AGENCY partner Greqi
3. Bashkia Pogradec partner Shqipëri
4. Bashkia Fier partner Shqipëri.

Vlera totale e projektit për të dyja palët shqiptare dhe greke është: 1.800.000 euro

Buxheti për Bashkinë Pogradec është 394.616 euro nga të cilat: 315.692,20 euro Kontribut i BE dhe 78.692,80 euro bashkefinancim i Bashkisë Pogradec.

Bazuar në buxhet, Bashkia Pogradec ka detyrimin e kostos së bashkëfinancimit të projektit dhe TVSH-së.

Thirrja në të cilën bazohet shkrimi i këtij projekti lidhet me ekonominë qarkulluese. Në nivel ministror janë targetuar dy bashki në Republikën e Shqipërisë për të qënë pjesë e aplikimit në këtë thirrje. Pas konsultimit me strukturat drejtuese në bashki, bazuar në nevojat dhe prioritetet e bashkisë është menduar që fokusi i projektit të jetë menaxhimi efikas i mbetjeve; ndarja dhe riciklimi duke qënë në këtë mënyrë koherent me fushën që mbulon kjo thirrje.

Koncepti i "Parkut të Ekonomisë Qarkulluese" - është një koncept që promovon parimet e një ekonomie qarkulluese brenda një zone specifike gjeografike. Ai synon zhvillimin dhe zbatimin e zgjidhjeve për nxitjen e ekonomisë qarkulluese në zonën ndërkufitare. Ai është projektuar për të krijuar një sistem të mbyllur ku burimet maksimizohen, mbetjet minimizohen dhe ndikimi i përgjithshëm mjedisor zvogëlohet.

Problemi i identifikuar

Bashkia e Pogradecit vjen me një ide që nxjerr në pah një problem që ka të bëjë me ndotjen që i bëhet bregut të liqenit të Ohrit nga nxjerrja e vazhdueshme e algave të tij në pjesën shqiptare, pasi drejtimi i erës dhe rrymat e liqenit i sjellin kryesisht në këtë breg. Kjo krijon një shkallë të lartë ndotjeje të bregut dhe procesi i degradimit të tyre çliron gazra me aromë të pakëndshme në mjedis. Aktualisht, procesi i grumbullimit të këtyre algave bëhet nga një subjekt i kontraktuar nga Bashkia Pogradec.

Projekt ideja që duam të paraqesim.

Ideja është përpunimi i këtyre mbetjeve të liqenit, kryesisht algave, përmes një procesi grumbullimi fillimisht në vend, duke ulur volumin dhe duke e bërë transportin më efikas. Më pas transporti dhe depozitimi në një vend të dedikuar për këtë në një sipërfaqe në pronësi të Bashkisë Pogradec dhe më pas përpunimi me synimin për t'i kthyer ato në pleh organik. Ky pleh organik nuk do të ketë qëllime shitjeje por do të përdoret për plehrimin e zonave të gjelbra të bashkisë apo në ndihmë të familjeve bujqësore. Vendi ku do të bëhet grumbullimi dhe dekompozimi i algave të grumbulluara do jetë në fshatin Guras, në një vend depozitim në pronësi të Ujësjetllës Kanalizime SH.A Pogradec. Për këtë gjë, Bashkia Pogradec ka nënshkruar me këtë ndërmarrje një marrëveshje për një periudhë 10 vjecare përdorimi për këtë qëllim, kusht ky dhe i projektit.

Përfitimet që sjell zbatimi i këtij projekti:

-Shmangia e ndikimit negativ në turizëm

Mbledhja e këtyre algave, depozitimi i tyre në një vend të dedikuar për riciklim do të ndikojë në ruajtjen dhe mbrojtjen e ekosistemit, duke mundësuar një mjedis më të pastër të bregut të liqenit të qytetit të Pogradecit, duke qenë një qytet turistik i vizituar në katër stinët e vitit. Prania e tyre mund të shkaktojë një pamje të padëshirueshme dhe të kufizojë përdorimin e bregdetit nga njerëzit. Pastrimi i tyre mund të ndihmojë në ruajtjen e atraktivitetit të zonës për turistët dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm.

-Kultivimi i tyre mund të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së ujit:

Algat e mbledhura nga bregu i liqenit zakonisht janë të dekompozuar dhe mund të shkaktojnë probleme të cilësisë së ujit nëse nuk trajtohen.

-Përpunimi i tyre ndikon në përmirësimin e estetikës dhe shfrytëzimit të bregut të liqenit:

-Parandalimi i ndotjes së ajrit:

Algat e vdekura mund të shkaktojnë një shkallë të lartë dekompozimi, duke lëshuar gazra të ndryshëm në ajër, duke përfshirë squfurin dhe amoniakun.

Përfitim financiar.

Duke qenë në pronësi të Bashkisë Pogradec këto makineri do shmangin koston që paguan deri tani Bashkia për kontraktimin e subjekteve që realizojnë pastrimin e breg liqenit.

Nëpërmjet blerjes së dy makinerive, një makinerie të teknologjisë së fundit e cila bën të mundur mbledhjen e algave në ujë dhe në tokë dhe një tjetre që mundëson grumbullimin e tyre anës bregut do të realizohet procesi i mbledhjes.

Njësia e Integrimit Evropian, me qëllim përmbushjen me sukses të objektivave të procesit të integrimit evropian, ku kusht është dhe zbatimi me rigorozitet i projekteve IPA Ndërkufitare duke kaluar të gjitha hallkat ligjore që nga miratimi në Këshillin Bashkiak deri tek kontrolli dhe

çertifikimi i shpenzimeve, kërkon vlerësimin e impaktit të këtij projekti nga Këshilli Bashkiak, miratim të implementimit në rast aprovimi të projektit dhe mbështetjen për të çuar para këtë projekt.



Ftojmë Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim.

Ju faleminderit!

Konceptoi: I. KOSTALLARI


Pranoi: B. ÇOMO

Miratoi: P. ZIKO

Konfirmoi: D. BABASULI

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A
POGRADEC

BASHKIA POGRADEC

Nr. 1122 Prot.

Nr. 4742 Prot.

Pogradec më, 18/11 .2024

Pogradec më, 15/11 .2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

BASHKISË POGRADEC

DHE

SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME
SH.A POGRADEC

“ Për vënien në dispozicion të një pjesë të ambienteve ku bëhet mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura si dhe të impianteve të pastrimit të tyre, në rast nënshkrimit të kontratës së grantit të financuar nga Bashkimi Evropian në projektin strategjik: "Perspektivat Qarkulluese: Transformimi i Menaxhimit të Mbetjeve në Territorin Ndërkufitar (TWIST)”. ”



Sot më datë 15/11 .2024, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi midis palëve:



PALËT E MARRËVESHJES

1. **Bashkia Pogradec**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z.**Ilir XHAKOLLI**, me adresë **Bulevardi "Rreshit Çollaku" Lagjia nr.2 Pogradec**, (në vijim referuar si "Bashkia Pogradec").
2. **Shoqëria Rajonale, Ujësjellës Kanalizime Sh.a Pogradec** me seli në **Guras, Seli/Zyra Qëndrore Lagjia 2, Pogradec** me Administrator z **Johan STERJO**, në cilësinë e mbështetësit të projektit për të cilin lidhet marrëveshja (në vijim "UK SH.Pogradec").

Duke qenë se palët:


Flerësojnë rëndësinë e përmirësimit të cilësisë së ujit dhe mjedisit të liqenit të Ohrit, si dhe mbrojtjen dhe promovimin e biodiversitetit të zonës, në kuadër të Programit Interreg **VI-A IPA CBC "Greece - Albania 2021-2027"**, me Aks Prioritar 1 - Mbështetja e kalimit drejt rajoneve ndërkufitare më të gjelbra dhe më të qëndrueshme.

Konsiderojnë se një ndër objektivat kyç në ushtrimin e veprimtarisë ndërmjet tyre, është efikasiteti, solidariteti dhe garantimi i funksionimit të shërbimeve ndaj komunitetit në nivel vendor.

Synojnë rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe Shoqërisë Rajonale, Ujësjellës Kanalizime Sh.a Pogradec, për një ekonomi më të gjelbër, me karbon të ulët, që kalon drejt një Europe, pa karbon dhe të qëndrueshme duke promovuar kalimin e drejtë dhe të pastër të energjisë, investimet e gjelbra dhe blu, ekonominë rrethore, zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen, parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve, si dhe lëvizshmërinë e qëndrueshme urbane me Objektiv Specifik 1.4 - O.S. 2.6 - Promovimi i kalimit drejt një ekonomie rrethore dhe efikase në përdorimin e burimeve dhe me Projekt "**Parku i Ekonomisë Rrethore**", i cili synon zhvillimin dhe zbatimin e zgjidhjeve për promovimin e ekonomisë rrethore në zonën ndërkufitare.

Riafirmojnë vullnetin dhe vendosmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në procesin e zbatimit të lëgjislacionit respektiv për pasjen e një kuadri institucional dhe infrastrukturor mbështetës në qasje të përmirësimit të praktikave e menaxhimit të mbetjeve në rajonet kufitare duke zbatuar parimet e ekonomisë qarkulluese duke pasur në fokus reduktimin e mbetjeve, promovimin e riciklimit dhe fusterimin e bashkëpunimit mes qeverive lokale.

Konfirmojnë angazhimin institucional për të siguruar standarte të larta të veprimtarisë në realizimin e procesit të grumbullimit të algave që nxirren nga Liqeni i Ohrit, për qëllime të përmirësimit të cilësisë së ujit dhe mjedisit të liqenit, si dhe për mbrojtjen dhe promovimin e biodiversitetit të zonës.



Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, në vijim e katër Marrëveshje:



Neni 1 OBJEKTI


Objekti i kësaj Marrëveshje mes palëve konsiston në vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe Shoqërisë Rajonale, Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Pogradec, për vënien në dispozicion të një pjesë të pasurisë nr. 230,, vol 6, fq. 243, ZK 1903, e llojit "Pa fryt", me sipërfaqe totale 88633 m2, me kufizime: V: Pas nr.116/1, L: Pas nr.229, J: Pas nr.231, P: Pas nr. 15, e ndodhur në fshatin Guras, Njësia Administrative Buçimas, Bashkia Pogradec, pasuri e cila është në pronësi të Shoqërisë Rajonale, Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Pogradec, sipas Certifikatës për vërtetim pronësie, dt. 13.12.2005, pra një pjesë e ambienteve të vaskave të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Pogradec sh.a, ku bëhet mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura si dhe të impianteve të pastrimit të tyre, realizimin e procesit të grumbullimit të algave që nxirren nga Liqeni i Ohrit, transportimin e tyre në pikën e vend grumbullimit dhe kthimin e tyre në pleh organik për familjet bujqësore.

Neni 2 BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet ne nenin 26 dhe 27, gërma "a" e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2025, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, neni 24 i Ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Ligjit Nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, Ligjit nr.9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar.

Neni 3 QËLLIMI

Palët bien dakord të bashkëpunojnë midis tyre me qëllim implementimin në rast nënshkrimi të kontratës së grantit të financuar nga Bashkimi Evropian në projektin strategjik: "Perspektivat Qarkulluese: Transformimi i Menaxhimit të Mbetjeve në Territorin Ndërkufitar (TWIST)" dhe për të kryer procesin e riciklimit të algave të mbledhura nga bregu i liqenit të Ohrit në qytetin e Pogradecit, për qëllime të përmirësimit të cilësisë së ujit dhe mjedisit të liqenit, si dhe për mbrojtjen dhe promovimin e biodiversitetit të zones ku të përmirësojë praktikatat e menaxhimit të mbetjeve në rajonet kufitare duke zbatuar parimet e ekonomisë qarkulluese dhe me fokus në reduktimin e mbetjeve, promovimin e riciklimit dhe fosterimin e bashkëpunimit mes qeverive lokale.





Neni 4

ROLET DHE PËRGJEGJESITË E PALEVE

Me anë të kësaj marrëveshjeje përcaktohen rolet, përgjegjësitë dhe bashkëpunimin në mënyrë, që projekti të zbatohet me sukses.

1. Kontributet e Bashkisë Pogradec:

- 1.1 Bashkia Pogradec, nëpërmjet strukturave të saj përgjegjëse, merr përsipër të zbatojë me përpikmëri kontratën e grantit të projektit në rast nënshkrimi të saj dhe të zbatojë marrëveshjen e nënshkruar me Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Pogradec, për vijimin e funksionimit të shërbimeve ndaj komunitetit në nivel vendor.
- 1.2 Të sigurojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme për transportimin e algave për në vendin e caktuar, në zbatim të kësaj marrëveshjeje.
- 1.3 Të mbledhë dhe transportojë algat e depozituara në bregun e liqenit të Ohrit, në territorin e Bashkisë Pogradec Pogradecit, deri në ambientet e përcaktuara të vaskave, të ndodhura në fshatin Guras, Njësia Administrative Buçimas, në pronësi të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Pogradec sh.a, ku bëhet mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.
- 1.4 Të sigurojë bashkëpunimin e personit kompetent me qëllim koordinimin e veprimtarisë dhe funksionimit të kësaj marrëveshjeje.
- 1.5 Të miratojë protokollin e përbashkëta të punës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.


2. Kontributet e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës - Kanalizime Sh.a Pogradec:

- 2.1 Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës- Kanalizime Pogradec sh.a, duhet të vendosë në dispozicion të ambienteve përkatëse, konkretisht të vaskave ku bëhet mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura si dhe të impianteve të pastrimit të tyre, në të cilin do të bëhet hedhja e algave dhe riciklimi i tyre në pleh organik.
- 2.2 Të caktojë personin përgjegjës që do të ndjekë me përpikmëri ecurinë e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.
- 2.3 Të miratojë protokollin e përbashkëta të punës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

VEPRIMTARITË E PËRBASHKËTA

Palët nëpërmjet strukturave të tyre kompetente të përcaktuara në Nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje, marrin përsipër të kryejnë bashkërisht:





- 5.1 Bashkërendimin e punës dhe dhënien e informacionit për kontratën e grantit për projektin strategjik: "Perspektivat Qarkulluese: Transformimi i Menaxhimit të Mbetjeve në Territorin Ndërkufitar (TWIST), në rast të nënshkrimit të saj.
- 5.2 Të caktojnë nga një person kontakti për secilin institucion ku do të mbajnë takime ndërmjet tyre në vazhdimësi dhe do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e dy institucioneve, në varësi të nevojës për bashkërendimin e punës në zbatim të kësaj marrëveshjeje.

Neni 6 AFATI

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të mbetet në fuqi për një afat të pacaktuar por jo më pak se 10 (dhjetë) vjet nga dita e nënshkrimit, me të drejtë ripërtëritje. Çdo zgjatje e kësaj periudhe duhet të bëhet me pëlqimin e të dyja palëve dhe të formalizohet në formë shkresore

Neni 7 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje e mundshme që mund të lindë midis palëve, do të zgjidhet me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre. Në rast se palët nuk arrijnë një marrëveshje, për zgjidhjen e çështjes, mund t'i referohen gjykatës kompetente.

Neni 8 DISPOZITAT E FUNDIT

- 8.1 Palët janë të detyruara të respektojnë këtë Marrëveshje, megjithëse është parashikuar në nenin 6 të kësaj marrëveshjeje, kjo marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht me shkrim, palën tjetër, vetëm nëse rrethanat çenojnë ligjshmërinë dhe zbatimin me sukses të marrëveshjes.
- 8.2 Bashkia Pogradec dhe Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Pogradec sh.a pranojnë dhe miratojnë të gjitha kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.
- 8.3 Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale nga të dyja palët, dy prej të cilave depozitohen në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Pogradec sh.a dhe dy të tjera në Bashkinë Pogradec.
- 8.4 Të gjitha njoftimet, apo komunikimet në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje bëhen me shkrim dhe i dërgohen Palëve, në adresat e mëposhtme:


PËR BASHKINË POGRADEC

Adresa:

Bulevardi "Rreshit Çollaku"

Lagjia nr.2, Pogradec

info.bashkiapg@bashkiapogradec.gov.al





PËR SHOQËRINË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME SH.A POGRADEC


Adresa:

Guras, Pogradec
Seli/Zyra Qendrore Lagjia 2,
Ujësjetllësi, Pogradec

PËR

SHOQËRINË RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A
POGRADEC:

ADMINISTRATOR



PËR

BASHKINË POGRADEC

KRYETAR

